



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtor.a për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 09 Më Dt. 03.01.2025  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

3/1/2025



# Raport Vjetor- DBPZHR 2024



JANAR - DHJETOR  
DBPZHR

## Përmbajtja

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	3
Aktivitetet në periudhën: Janar, Shkurt, Mars .....	3
Aktivitetet në periudhën: Prill, Maj, Qershor.....	4
Përkrahja e Fermerëve me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit.....	4
Përkrahja e fermerëve me Pleh Artificial .....	5
Pagesat Direkte - Subvencionet 2024 .....	5
Qent Endacak:.....	7
Aktivitetet në periudhën: Korrik, Gusht, Shtator .....	7
Festat me karakter bujqësor: Agrofesta dhe Festa e Vjeljes së Rrushit - Hardhfest 2024.....	8
Aktivitetet në periudhën: Tetor, Nëntor, Dhjetor. ....	9
'Përkrahja e Fermerëve Blegtor' .....	9
Ndërtimi i Serrave për fermerë .....	9
Projektet e investimeve kapitale .....	10
Kanalet e kullimit .....	10
Pastrimi i përrrenjëve .....	10
PËRFUNDIM.....	11

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Përmes politikave dhe strategjive tentojmë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas të resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2024, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vete aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.

### Aktivitetet në periudhën: Janar, Shkurt, Mars

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete.

Aktivitetet të cilat kryhen vazhdimisht siq janë pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: vërtetim për fermer që dëshmon se janë prodhues bujqësorë, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, si dhe barazimi mujor i të hyrave me Drejtorinë e Financave për muajt Janar, Shkurt dhe Mars etj.

Ndërsa aktivitetet më kryesore paraqiten të specifikuara sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023 për fermerët blegtor (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga: **15 janar deri më 13 shkurt 2023**.
- Gjithësej kanë aplikuar **91** blegtorë, me gjithsej: **1,709,950** litra qumësht dhe **522** krerë të viçave për majmëri
- Kemi mbajtur takim me Agjensionin Pyjor, ku dhe ju kemi bartur kompetencat për stafin e Pylltarisë.
- E kemi përfunduar Cash planin për vitin 2024.
- Është nënshkruar kontrata “Furnizim me preparate për luftimin e insektit cikadia të hardhisë së rrushit”
- Është nënshkruar kontrata me Qendrën Grumbulluese “Agro Celina”, në vitin 2024 e cila do të furnizojë bujqit me Fidane dhe inpute tjera për kulturën e trangullit “Kornishan” Përmes kësaj marrëveshje do të mbulohen: Fidanet cilësore të trangullit, Plehërimi dhe Riplehërimi (kristalorët), Pesticidet, Mulqerimi ( Folia e zezë), Sistemi i ujitjes pikë-pikë.



- Gjatë muajit janar për shkak të erës së fuqishme, kanë ndodhur disa dëme, kemi pranuar informata nga disa fermerë që iu janë shkaktuar dëme dhe të cilëve më pas iu kemi pranuar kërkesat e tyre dhe komisioni ka dalë në terren për verifikim të dëmeve.
- Poashtu gjatë muajit janar ne si Drejtori dhe si Komune e Rahovecit e kemi përmbyllur raportin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2023 duke proceduar edhe ne Kuvendin e Komunës .
- Në sektorin e blegtorisë kemi ndërmarrur aksion për trajtim, kontroll dhe vaksinim të bagëtive të trasha dhe bagëtive të imëta, veterinari i angazhuar ka kryer vaksinimin e bagëtive **1,915** krerë lopë dhe rreth **7,500** dele. Gjithsej janë vizituar **121** ferma blegtorale.



## Aktivitetet në periudhën: Prill, Maj, Qershor

### Përkrahja e Fermerëve me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit

Nga 6 mars deri më 20 mars , ka qenë e hapur thirrja për aplikim: Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit. Gjithsej kanë aplikuar **495** fermerë Vreshtarë.

Është formuar komisioni për verifikimin e aplikacioneve për thirrjen :Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit, komisioni ka publikuar raportin dhe listën e **495** përfituesvetë preparatit.

Poashtu është bërë rishpallja e thirrjes: Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit, e cila ka qenë e hapur nga data 24 maj deri më 3 qershor 2024. Komisioni ka formuar sërish raport dhe ka publikuar listën me **82** përftues. Përftuesit e këtij preparati janë njoftuar dhe janë furnizuar.



Thirrja për aplikim	Afati për aplikim	Nr. i përfituesve
Furnizim me preparate	06.03.2024 - 20.03.2024	495 vreshtarë
Rishpallja e thirrjes	24.05.2024 - 03.06.2024	82 vreshtarë

# Raporti Vjetor-DBPZHR | janar-dhjetor 2024

## Përkrahja e fermerëve me Pleh Artificial

Gjatë muajit muajit maj është hapur thirrja: Përkrahja e fermerëve me PLEH ARTIFICIAL, afati i aplikimit ka qenë nga data: 02.05.2024 deri më 22.05.2024. Gjithsej kemi pranuar 1,134 aplikacione. Komisioni i ka verifikuar aplikacionet, është shpallur lista përfituese dhe fermerët përfitues janë duke e kryer participimin prej 20%.

Thirrja për aplikim	Afati për aplikim	Numri i përfituesve
Pleh Artificial	02.05.2024 - 22.05.2024	1128 fermer

## Pagesat Direkte - Subvencionet 2024

Më 13 mars është hapur aplikimi për pagesa direkte/subvencione për 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore. Për sektoret, të cilët do të mbështeten përmes Programit për Pagesa Direkte 2024, afati për aplikim ka qenë i hapur deri më 12 prill 2024, mirëpo pas kërkesës tonë, është zgjatuar deri më 29 prill 2024.

Ne si drejtori e BPZHR-së jemi angazhuar të mobilizohemi me zyret në Krushë të Madhe dhe Ratkoc ashtu sikurse edhe vitet e kaluara që fermerët e disa vendbanimeve të mos krijojnë fluks të madh në zyrat e DBPZHR-së në Rahovec, por aplikimin të kenë mundësi ta kryejnë edhe në këto dy qendra të mëdha poashtu kemi bërë kërkesë për hapjen e userave për zyrtarët të cilët kanë pranuar aplikacione të bujqëve.

Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2024 është 3,099 ku krahasuar me vitin 2023 kemi 20 aplikacione më pak.

Sikurse në vitet e kaluara pas përfundimit të procesit dhe dorëzimit të aplikacioneve në AZHB, në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë bëhet regjistrimi i të dhënave të fermerëve që kanë aplikuar për secilën kulturë bujqësore. Këto të dhëna më pastaj përlllogariten, analizohen dhe krahasohen me vitet paraprake.

**Tabela me të dhënat e kulturave bujqësore të ndara me sektorë dhe të shprehura në sipërfaqe me ha, për të cilat kanë aplikuar fermerët e Komunës tonë.**

Të dhënat e fermerëve		2022	2023	2024	Diferenca 2024/2023
Sektori i Lavërtarisë		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	Sip. në ha
1	Grurë	2,006.21	2,743.61	2520.53	-223.08
2	Misër	1,578.94	1,943.60	1875.96	-67.64
3	Elb	4.05	1.12	6.5	5.38
4	Tersher	122.04	80.01	99.9	19.89
5	Theker	0.00		1.72	1.72

# Raporti Vjetor-DBPZHR | janar-dhjetor 2024

Gjithsej		3,711.24	4,768.34	4,504.61	-263.73
<b>Sektori i Vreshtarisë</b>		Sip ne ha	Sip në ha	Sip në ha	
	Loji I kulturës				
1	Rrush	2,322.21	2,274.57	2,216.29	-58.28
2	Fidane të hardhisë	149,900.00	124,000.00	127,000.00	3,000.00
<b>Sektori i Perimkulturës</b>		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	Speca	695.30	616.41	695.30	78.89
2	Domate	11.48	9.66	17.41	7.75
3	Qepë	149.76	186.78	235.47	48.69
4	Hudhër	25.56	20.37	14.66	-5.71
5	Patate	166.35	189.22	260.02	70.80
6	Tranguj	0.43	0.74	0.61	-0.13
7	Karota	7.65	7.14	6.38	-0.76
8	Rrepkë	0.00	0.49	0.00	-0.49
9	Brokuli	0.25	0.00	0.30	0.30
10	Fasule	0.46	1.90	2.70	0.80
11	Pangjar	0.00	0.00	0.00	0.00
12	Lakër	144.20	70.65	134.97	64.32
13	Lulelakër	10.82	10.23	8.06	-2.17
14	Presh	0.20	0.00	0.57	0.57
15	Spinaq	0.84	0.48	0.85	0.37
16	Marule	0.64	0.90	1.68	0.78
<b>Gjithsej</b>		<b>1,213.94</b>	<b>1,114.97</b>	<b>1,378.98</b>	<b>264.01</b>
<b>Kungullore</b>		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	Shalqinj	164.68	171.68	353.99	182.31
2	Pjepër	100.24	84.49	98.71	14.22
3	Kunguj	11.82	6.58	23.80	17.22
4	kungull I Gjelbert	302.84	160.41	242.77	82.36
<b>Gjithsej</b>		<b>579.58</b>	<b>423.16</b>	<b>719.27</b>	<b>296.11</b>
<b>Sektori i Pemptarisë</b>		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	Dardhë	6.63	7.81	3.46	-4.35
2	Dredhëz	2.72	2.09	1.19	-0.90
3	Kumbull	54.86	62.65	49.92	-12.73
4	Mollë	8.96	10.26	8.70	-1.56
5	Arra	73.90	95.15	92.86	-2.29
6	Lajthi	10.77	9.22	9.52	0.30
7	Ftoj	4.17	3.86	3.86	0.00
8	Mjeder	0.53	0.00	0.00	0.00
9	Pjeshkë	2.69	3.27	2.96	-0.31
<b>Gjithsej</b>		<b>165.23</b>	<b>194.31</b>	<b>172.47</b>	<b>-21.84</b>
<b>Sektori i Blegtorisë dhe Shpezetarisë</b>					
1	Bletë	4,245.00	4,793.00	5,276.00	483.00
2	Lopë	1,938.00	1,953.00	1,966.00	13.00
3	Dhi	248.00	167.00	150.00	-17.00
4	Dele	7,226.00	7,396.00	5,244.00	-2,152.00

## Raporti Vjetor-DBPZHR | janar-dhjetor 2024

5	Pula vojëse	59,100.00	60,260.00	52,000.00	-8,260.00
Nr.	Lloji I kulturës	Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	<b>BMA</b>	<b>16.51</b>	<b>8.54</b>	<b>10.96</b>	2.42
					0.00
<b>Perime në Serra</b>					0.00
1	Perime	24.26	27.21	28.77	1.56

Nga tabela e prezantuar me lartë mund të vërehet se këtë vit kemi rritje në sektorin e perimkulturës, konkretisht të kultura e Specit, Shalqinit, Patates, Lakrës dhe qepës, ndërsa zbritje në sipërfaqet e mbjellura kemi të drithërat si: Grurë dhe Misër.

### Qent Endacak:

Ka vazhduar aksioni për trajtimin e qenve endacak gjatë gjithë kësaj periudhe raportuese, në disa lokacione të komunës sonë, ku shpresojmë që deri në kohën e ardhjes së mërgimtarëve të kemi gjendje më të mirë në terren. Poashtu jemi duke bashkëpunuar me përfaqësues të KFOR-it LMT lidhur me përkrahje për trajtim të qenve endacak nga CIMIC-u gjerman, ku jemi në pritje të një përgjigje të një projekti që kemi aplikuar.

Nga data **31.05.2024** deri më **14.06.2024** ka qenë e hapur thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve për organizimin e festivaleve tradicionale dhe kulturore si: Festa e Vjeljes së Rrushit – 7 shtatori dhe Agrofesta për vitin 2024. Është formuar komisioni dhe është zgjedhur OJQ përfituese.

### Aktivitetet në periudhën: Korrik, Gusht, Shtator

Muaji korrik është edhe muaji i korrje-shirjeve, ku është formuar komisioni për përcjelljen e këtij procesi, i cili ka dalur në terren dhe dhe në bazë të dhënave këtë vit rendimenti është ka qenë i kënaqshëm dhe mesatarja për një hektar është sillur nga 4,000 kg deri në 6,000 kg. Poashtu raportin për fushatën e korrje-shirjeve e kemi përcjell edhe në MBPZHR

Gjatë muajit korrik ka vazhduar nënshkrimi i kontratave me fermer si dhe pjesa e participimit prej 20%.

Po ashtu është bërë shpërndarja e plehut për fermerët të cilët e kanë kryer participimin në fazë të parë, sasia e shpërndarë është **5,000 thasë**, për **547** fermerë.



Nga **01.08.2024- 01.09.2024** ka qenë e hapur thirrja nga MBPZHR-ja për Litrazhë të qumështit të dorëzuar, Sasinë e grurit të dorëzuar dhe për Pleh Artificial në kuadër të MBPZHR-së.

Gjithsej kane aplikuar **804** fermerë.

Sasia e kg të grurit të aplikuar: **7.942.292 kg**

Sipërfaqja e aplikuar për subvencionim të plehut artificial: **3935 Ha**

Numri i viqave: **692 viqa**

Sasia e qumështit: **1,899,154 litra**



### **Festat me karakter bujqësor: Agrofesta dhe Festa e Vjeljes së Rrushit - Hardhfest 2024**

Gjatë muajve Gusht dhe Shtator është bërë organizimi i festave me karakter bujqësor si Agrofesta dhe festa e vjeljes së rrushit- Hardhfest

**Agrofesta** është mbajtur me **3 dhe 4 Gusht**, në Krushë të Madhe, ku janë promovuar prodhimet bujqësore, produktet e ndryshme bujqësore, ushqimet tradicionale etj.



**Festa e Vjeljes së Rrushit - Hardhfest** është mbajtur me **6, 7 dhe 8 Shtator** në Rahovec, ku janë zhvilluar shumë aktivitete dhe ka pasur vizitor nga vende të ndryshme.





Padyshim që ky edicion ka arritur sukses të jashtëzakonshëm duke i tejkaluar pritshmërit për faktin se një numër i madh i vizitorëve kanë qenë të huaj.

## Aktivitetet në periudhën: Tetor, Nëntor, Dhjetor.

### ‘Përkrahja e Fermerëve Blegtor’

Është publikuar thirrja “Përkrahja e Fermerëve Blegtor”, nga data 24.09.2024 deri më 08.10.2024, gjithsej kanë aplikuar **247** fermerë, të gjithë aplikuesit janë shpallur përfitues dhe pagesat janë ekzekutuar me 29 tetor. Përmes kësaj përkrahje për herë të parë në këtë formë janë shpërndarë **57,700€** për 247 fermer blegtor e ku janë përfshirë edhe fermerët e vegjël të cilët nuk përfshihen në skemën e subvencioneve të MBPZHR-së.

Thirrja për aplikim	Afati për aplikim	Numri i përfituesve
Përkrahja e Fermerëve Blegtor	24.09.2024 - 08.10.2024	247 blegtorë

### Ndërtimi i Serrave për fermerë

Gjatë muajit shtator është publikuar thirrja “Përkrahja e Fermerëve me Serra për fermerët e komunës së Rahovecit” e cila ka qenë e hapur nga data 17.09.2024 deri më 01.10.2024, ku gjithsej kanë aplikuar **135** fermerë.

Është publikuar lista e përfituesve për serra ku gjithsej kanë përfituar **48** fermerë.

Afati i ankesave ka qenë i hapur 7 ditë nga 14.10.2024- 21.10.2024, me ankesa kanë përfituar serra edhe **42** fermerë.

Përkrahja e fermerëve me serra	Serra 3 ari	Serra 5 ari
Lista e parë	22 përfitues	26 përfitues
Lista me ankesë	35 përfitues	7 përfitues

Është duke u kryer participimi 20 % për serra, si dhe ndërtimi i tyre te fermerët përfitues.

Gjatë muajit tetor ka vazhduar nënshkrimi i kontratave me fermer si dhe pjesa e participimit prej 20%, për pleh artificial.

Po ashtu është bërë shpërndarja e plehut për fermerët të cilët e kanë kryer participimin në fazë të dytë, sasia e shpërndarë është **4,000** thasë për **375** fermerë.

Poashtu jemi furnizuar edhe me pjesën e fundit me pleh Artificial ku gjatë muajit nëntor ka përfunduar edhe shpërndarja te fermerët përfitues me **1,020** thasë.

### Projektet e investimeve kapitale

#### Kanalet e kullimit

**Kanali i Kullimit të tokave bujqësore në Ratkoc** – Ka përfunduar edhe ndërtimi urës në pjesën e poshtme të fshatit që është pozicion i veçant në projekt. Tani është duke u bërë rregullimi i shtratit afër kësaj ure dhe pas përfundimit të këtyre ndërhyrjeve përfundojnë edhe punimet në këtë projekt. Sfid mbetet mirëmbajtja dhe pastrimi.

**Kanali i Kullimit nga Shtavica deri ne Fortese-** Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e kanalit aktualisht është duke u betonuar baza e kanalit si dhe ndërtimi i skarpateve, poashtu në këtë periudhë është ndërtuar edhe ura e fundit e paraparë me projekt te mulliri Hoxha. Ka mbetur edhe segmenti i fundit në gjatësi prej 850 m, por në për këtë periudhë punimet janë ndërprerë pasi që edhe kushtet atmosferike janë te pafavorshme e poashtu edhe mungesë e mjeteve financiare.

**Kanali i Kullimit në Çifllak-** Ka përfunduar edhe ndërtimi i urës në qendër të fshatit dhe janë duke vazhduar punimet në segmentin e fundit në drejtim të drinit të bardhë.

**Kanali i Kullimit Fortesë – Celinë** – Ky projekt ka përfunduar dhe tani ka filluar ndërtimi i fazës së dytë i cili do të shkarkojë ujërat në drejtim të lumit drini i bardhë, ky projekt financohet me grantin e performancës. Aktualisht është duke u punuar në ndërtimin e kanaleve që bartin ujin e pjesës kodrinore dhe do të vazhdohet me kanalin për shkarkim në kanalin e fshatit Celinë

**Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore** - ka filluar zbatimi i kontratës në trajtimin e rrugëve fushore, kanë përfunduar segmentet e planifikuara në fshatrat: Zoqisht, Retijë, Retijë e Poshtëme aktualisht është duke u punuar në Zonën Kadastrale të qytetit, konkretisht në degëzimet e rrugës Hamoc-Fortesë, poashtu punimet janë duke vazhduar në segmentin Rahovec-Celinë ku do të bëhet edhe ndërlikja e rrugëve që shkojnë në fshatrat Hoçë e Vogl dhe Nagafc.

#### Pastrimi i përrenjëve

Pastrimi i kanaleve dhe përrenjëve ka pasur fokusin kryesor në këtë pjesë të parë të vitit. Kemi intervenuar në shumë lokacione si: Rahovec (rimnik), Nagafc, Zoqisht, Kramovik, Xërxë, në dalje të fshatit Ratkoc, konkretisht te pompa e derivateve DINA-H, poashtu sipas kërkesës se banorëve të fshatit Gexhë e kemi pastruar segmentin ne hyrje të fshatit në mes të fshatit Malësi e Vogel deri më tani i patrajtuar ndonjë herë. Po ashtu janë pastruar përrenjt në Xërxë edhe në Fortesë në disa Segmente.

## PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në kontakt të vazhdueshëm me fermer duke i takuar fermerët në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre e poashtu duke dëgjuar me vëmendje brengat, shqetësimet dhe kërkesat e tyre.

Zyrtarët kanë qenë të gatshëm për çdo vlerësim dëmi me të cilët fermerët e komunës sonë ballafaqohen, ata dalin në terren në qdo fatkeqësi natyrore që ndodh dhe dëmton kulturat bujqësore.

03.01.2025

Rahovec

DREJTORI I DBPZHR-së  
Berat Duraku

